



KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1118/ 10 prot.

Datë 12/06/2024

V E N D I M

Nr. 669/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12/06/2024, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “TRIMED” SHPK në procedurën e prokurimit “TRIMED” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-97276-03-04-2024, me objekt: “Blerje qese për mbledhjen dhe përpunimin e gjakut, sete dhe filtra deleukocitare, materiale mjekësore të ndryshme konsumi, sete dhe aksesore” e ndarë në lote”, me fond limit: 114,486,970 (njëqind e katërmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) Lekë pa TVSH ose fondi limit ne Euro (sipas kursit të këmbimit nga BSH): 1,101,365.75 (Një milion e njëqind e një mijë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë shtatëdhjetë e pesë) Euro pa Tvsh, Loti 1 me numër reference: REF-97281-03-04-2024, me objekt: “Qese gjaku për mbledhjen dhe përpunimin e gjakut”, me fond limit të lotit 26,260,000 (njëzet e gjashtë milion e dyqind e gjashtëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH ose fondi limit ne Euro (sipas kursit të këmbimit nga BSH): 252,621.45 (Dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e njëzet e një pikë dyzet e pesë) Euro pa TVSH zhvilluar në datën 05.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut.

Ankimues: Operatori ekonomik “*TRIMED*” SHPK me Nipt K51612031J me adresë: *Autostrada Tiranë -Durrës, Km 10, Zona Kadastrale 2105, Nr. Pasurie 95/11, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut
Adresa: Rruga Lord Bajron, Laprakë, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 05.03.2024 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-97276-03-04-2024, me objekt: “*Blerje qese për mbledhjen dhe përpunimin e gjakut, sete dhe filtra deleukocitare, materiale mjekësore të ndryshme konsumi, sete dhe aksesorë*” e ndarë në lote”, me fond limit: 114,486,970 (njëqind e katërmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) Lekë pa TVSH ose fondi limit ne Euro (sipas kursit të këmbimit nga BSH): 1,101,365.75 (Një milion e njëqind e një mijë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë shtatëdhjetë e pesë) Euro pa Tvsh, Loti 1 me numër reference: REF-97281-03-04-2024, me objekt: “*Qese gjaku për mbledhjen dhe përpunimin e gjakut*”, me fond limit të lotit 26,260,000 (njëzet e gjashtë milion e dyqind e gjashtëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH ose fondi limit ne Euro (sipas kursit të këmbimit nga BSH): 252,621.45 (Dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e njëzet e një pikë dyzet e pesë) Euro pa TVSH zhvilluar në datën 05.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut.

II.2. Në datë 05.04.2024 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 23.04.2024 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “ <i>TRIMED</i> ” SHPK	24,567,000 leke	skualifikuar
2. “ <i>BIOMETRIC ALBANIA</i> ” SHPK	25,676,000 leke	kualifikuar
3. “ <i>Mediline</i> ” SHPK	26,260,000 leke	skualifikuar

II.4. Në datën 23.04.2024, operatori ekonomik “*TRIMED*” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“-Origjina e mallit dhe kompania prodhuese e deklaruar në Deklaratën e OE nuk është e njëjtë me atë të paraqitur në certifikatën CE.

-Mostra për sol.aditiv PAS nuk përmban asnjë informacion.

-Nuk ka paraqitur katalog për solucionin aditiv PAS

-Nuk ka paraqitur certifikatë CE ose FDA (klas III) për sol.PAS

-Nuk ka informacion nëse qeset e gjakut kanë kaluar procesin e pasterizimit.

-Nuk ka informacion nëse OE do të sigurojë 3 pajisje automatike për ndarjen e gjakut dhe adaptues për kupa të centrifugës”.

II.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 29.04.2024 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke shpallur fitues shoqërinë “*BIOMETRIC ALBANIA*” SHPK.

II.6. Në datën 07.05.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4061 datë 07.05.2024, dhe me nr. 1118/2024 prot, datë 07.05.2024, e operatorit ekonomik “*TRIMED*” SHPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e

Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1118/2, datë 08.05.2024, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “TRIMED” SHPK, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Me shkresën nr. 66/40 prot, datë 17.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 1118/3 prot datë 20.05.2024, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit si dhe vendimarrja për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “TRIMDED” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit, me pretendimet si më poshtë vijon:

“... Në lidhje me pretendimet e ngritura nga OE ankimues TRIMED, për skualifikimin e tij, vlerësojmë si vijon:

- A. OE TRIMED është skualifikuar pasi:- origjina e mallit dhe kompania prodhuese e deklaruar në Deklaratën e OE nuk është e njëjtë me atë të paraqitur në certifikatën e CE.

Argumentimi i OE referuar këtij pretendimi është, referuar këtij pretendimi, KVO ka konkluduar gabim. OE ka ngarkuar në sistem aktin shkresor të lidhjes mes fabrikës prodhuese “XXXX” e cila, sikundër deklarohet dhe provohet përmes dokumentit të sipërcituar, është prodhuese ekskluzive e linjës “XXXX” sipas specifikimeve të përcaktuara nga kompania “XXXX”. Pra, kompania “XXXX” me seli qendrore në: XXXX, ka fabrikën e prodhimit të qeseve të gjakut “XXXX”, e cila në përmbushje të detyrimeve ligjore që burojnë nga vendi ku ndodhet, është e regjistruar në Kinë. duke qënë se lënda e parë për prodhimin e qeseve të gjakut përpunohet në këtë fabrikë, ky proces duhet të kalojë nëpër filtrat ligjorë të parashikuar nga direktiva EEC 93/42/EEC për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë. Për pasojë, kjo certifikatë do të mbaje emrin e fabrikës, e cila prodhon ekskluzivisht artikujt e linjës “XXXX”, sikundër dhe është ngarkuar në SPE nga OE. Duke qënë se specifikimet për prodhimin e tyre përcaktohen nga kompania “XXXX”, produkti përfundimtar mbart cilësimin si prodhues: “Demophorius Limited”. Kjo metodë prodhimi njihet nga vetë Direktiva 93/42/EEC si “Certifikimi i pajisjeve OEM”, ku OEM do të thotë “Original Equipment manufacturer”, dhe përballë këtij të fundit vendoset PLM (Private Label Manufacturer”. Sipas MDC “Certification of OEM Devices” 003/07.2016, pika 1 bën shpjegim të qartë dhe shterues si në vijim: “1. Certification of OEM Devices OEM: “Original Equipment Manufacturer”; Company that produces the finished devices for a private label manufacturer and in this case does not appear as the manufacturer in the meaning of the medical devices directives. PLM: “Private Label Manufacturer”; Company that appears as manufacturer in the meaning of the medical devices directives, but does not itself manufacture the device(s).”.

Kështu, në rastin konkret, prodhuesi "XXXX", si një subjekt më vete, në rolin e OEM, prodhon për llogari të Demophorius Limited, në cilësinë e PLM gamën e artikujve "XXXX", të cilat për pasojë marrin markimin "Made in XXXX" dhe "Manufacturer: XXXX". Ky fakt është evidentuar gjithashtu përmes markimit në katalogun e ngarkuar në SPE, dokumenti i emëruar "DOKUME-1", faqe 24. Pretendimi i KVO për mungesë të lidhjes mes origjinës së deklaruar dhe asaj të cituar në certifikatën CE të ngarkuar në sistem, pa u marrë parasysh dokumenti i lidhjes mes fabrikës së prodhimit dhe kompanisë që ka përcaktuar specifikimet e produkteve të prodhuara, është **një pretendim që gjen mbështetje ligjore vetëm sipas direktivës së re MDR 2017/745, sipas së cilës në rastin e OEM, duhet të përcaktohet saktësisht jo vetëm PLM, por edhe OEM.** Shohim me vend të sjellim në vëmendje të KVO se hyrja në fuqi e kësaj direktive ka ardhur me klauzolën e vlefshmërisë së certifikatave të lëshuara me bazë ligjore Direktivën 93/42/EEC për sa kohe ato janë lëshuar para hyrjes në fuqi të direktivës së re MDR 2017/745: "Article 120 - Transitional provisions 2. ... certificates issued by notified bodies in accordance with Directives 90/385/EEC and 93/42/EEC from 25 May 2017 shall remain valid until the end of the period indicated on the certificate, which shall not exceed five years from its issuance. They shall however become void at the latest on 27 May 2024.", për pasojë, siç mund të konstatohet nga certifikata CE e ngarkuar në SPE, lëshimi dhe hyrja në fuqi e saj datojnë më 2021-04-09 deri më 2024-05-26. Sa më sipër arsyeja juaj për skualifikim nuk qëndron.

KSHA analizoi të gjithë dokumentet e paraqitura nga OE TRIMED ShPK dhe rezultoi në pretendimi për këtë pikë nuk qëndron pasi:

- Në bazë të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3, b "OE duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese".

Në dokumentin e paraqitur pranë KVO "Shtojcat+Deklarata, Loti 1", fapja 1: OE deklaroi se Origjina e Mallit është XXXX dhe Kompania Prodhuuese është XXXX. Në dokumentin "Dokumenta Origjinale Loti 1", faqe 48 paraqitet një letër lidhje midis XXXX dhe XXXX me vendndodhje në XXXX, ku deklarohet se produktet prodhohen pranë kësaj kompanie në XXXX dhe jo në XXXX. Më poshtë edhe përkthimi në shqip i letrës lidhëse; "Ne, XXXX, ME vendndodhje XXXX deklarojmë se në bashkëpunim me Demophorius Limited, me vendndodhje në Cypris, prodhojmë ekskluzivisht QESE GJAKU DEMOTEK sipas specifikimeve të XXXX".(Dokumenti "Përkthime + Noterizime Loti 1, fapja 66). Kjo letër lidhëse tregon jo vetëm që produkti prodhohet në Kinë, por të dy kompanitë i prodhojnë këto produkte në bashkëpunim me njëra-tjetrën.

OE, në ankesën tij, ka paraqitur si shpjegim raportin OEM-PLM midis dy kompanive.

Për këtë raport nuk ka bashkangjitur asnjë dokument shtesë që sqaron natyrën dhe llojin e këtij bashkëpunimi, pikërisht sipas përcaktimeve të "Certification of OEM Devices" 003/07.2016 të cituar edhe nga vetë OE. Edhe nëse OE vërteton ekzistencën e bashkëpunimit OEM-PLM midis dy kompanive, ky bashkëpunim njihet Dermophorius si prodhues ligjor të produktit; përsëri nuk zhbën faktin që vendi ku prodhohet produkti është Kina dhe jo QIPRO, për rrjedhojë, origjina e mallit është Kinë, ndryshe nga çfarë është përcaktuar nga OE në deklaratën e tij.

- Nga të gjithë dokumentet dhe shpjegimet e vënë në dispozicion nga OE Trimed ShPK, konkludojmë se nuk ka përputhshmëri midis origjinës së mallit dhe kompanisë prodhuese të deklaruar nga OE në Deklaratën e tij, dhe asaj të paraqitur në dokumentet shoqëruar (Certifikatë CE, Certifikatë Konformiteti, Letër Lidhjeje etj.).

- Sa më sipër, pretendimi i Operatorit Ekonomik ankimues nuk qëndron.

OE TRIMED është skualifikuar pasi- Mostra për sol.aditiv PAS nuk përmban asnjë informacion.

Argumentimi i OE referuar këtij pretendimi është, KVO ka konkluduar gabim, pasi një informacion i tillë nuk është pasqyruar në proces-verbalin mbi mostrat e dorëzuar më datë 05.04.2024. Ky procesverbal është pranuar dhe nënshkruar nga OE dhe nga AK pa vërejtje duke i kualifikuar si të vlefshme. Nëse AK do kishte pretendime për mostrën duhet ti kishte ngritur dhe konstatuar që në procesverbalin e dorëzimit dhe marrjes së tyre në administrim. Nënshkrimi i procesverbalit të mostrave pa vërejtje nënkupton pranimin dhe përmbushjen e këtij kriteri. Referuar procesverbalit të datës 05.04.2024 për dorëzimin e mostrave nga ana e operatorit ekonomik "TRIMED" për artikullin e fundit Qese për prodhimin e trombociteve; "SOLUCION RUAJTËS PËR TROMBOCITET" është përcaktuar kompania "XXXX" XXXX. Pra ky konstatim i KVO i reflektuar në këtë procesverbal është totalisht shterues dhe konfirmon se mostra është marrë dhe administruar në rregull.

Sa më sipër arsyeja juaj për skualifikim nuk qëndron.

KSHA analizoi të gjithë dokumentet e paraqitura nga OE TRIMED ShPK dhe rezultoi se pretendimi për këtë pikë nuk qëndron.

Në bazë të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit për këtë Lot, pika 2.3.g: "Ofertuesit duhet të dorëzojnë mostra për të gjitha artikujt e shënuar me shënjen (*) në tabelën përkatëse për Lotin 1. Mostrat të dorëzohen pranë Komisionit të Vlersimit të Ofertave, në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, të mbyllura në një zarf/kuti jo transparente të vulosur mbi të cilin të shënohet: Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlersimit të Ofertave, të procedurës së prokurimit me objekt: "Blerje qese për mbledhjen dhe përpunimin e gjakut, sete dhe filtra deleukocitare, materiale mjekësore të ndryshme konsumi, sete dhe aksesore" e ndarë në lote - Marrveshje kuadër me disa operatorë ekonomike (një OE për secilin lot) ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara për një periudhë 12 mujore. - Mostrat duhet të paraqiten në datën dhe orën e përcaktuar për hapje dhe vlerësim ofertash." KVO merr në dorëzim për administrim në datën dhe orën e caktuar mostrat e sjella nga OE.

- Nënshkrimi i procesverbalit nënkupton që KVO ka marrë në dorëzim nga OE mostrat, dhe përmban shënime në rast se OE nuk paraqitet apo nuk sjell një mostër të kërkuar.

- KVO i merr në dorëzim këto mostra, dhe së bashku me dokumentacionin teknik të siguruar nga OE bën vlerësimin për secilën mostër, vlerësim ky që kërkon kohë dhe nuk mund të realizohet në momentin e marrjes në dorëzim të mostrave.

- Vlerësimi i mostrave i shtohet vlerësimit të dokumentacionit shoqëruar (koha në dispozicion x ditë) dhe pasqyrohet, siç ka ndodhur, në argumentet për kualifikim/skualifikim të OE përkatëse.

- KSHA ka vlerësuar mostrat e sjella nga OE si dhe gjithë dokumentacionin teknik, dhe konkludon se mostra për solucionin ruajtës për trombocitet nuk ka etiketë dhe nuk përmban asnjë informacion teknik, ndryshe nga mostrat e tjera të sjella nga ky OE.- Sa më sipër, pretendimi i Operatorit Ekonomik ankimues nuk qëndron.

OE TRIMED është skualifikuar pasi- **Nuk ka paraqitur katalog për solucionin aditiv PAS**

Argumentimi i OE referuar këtij pretendimi është KVO është nxituar në vlerësimin e mospërmbushjes së këtij specifikimi, pasi në katalogun e ngarkuar në SPE nga OE, i emëruar

“DOKUME-1”, në faqen 31, është markuar shënimi “qeset e gjakut shoqërohen me solucionin CPD dhe SAG-M, si dhe me kombinime të tjera ekzistuese. Qeset e gjakut XXXX sigurojnë variacione të gjëra kombinimesh të personalizuar”. Pra, nga sa më sipër duket qartë që OE e përmbush këtë kriter sepse prodhuesi garanton shoqërimin e qeseve të gjakut me të gjitha konfigurimet e variacioneve të solucioneve. Në rast se KVO nuk ishte e bindur, mund të përdorte mjetin ligjor kërkesë për sqarim: parashikuar nga Neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, pika 1 ku parashikon: “Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.”.

Sa më sipër arsyeja juaj për skualifikim nuk qëndron.

KSHA i analizoi të gjithë dokumentet e paraqitura nga OE TRIMED ShPK dhe rezultoi se pretendimi për këtë pikë nuk qëndron.

- Në bazë të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit për këtë Lot, pika 2.3, e: “Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur sipas numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës. (Katalogët duhet të ngarkohen në ëëë.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT (Dokumentat duhet të jenë të perkthyer dhe të noterizuara) Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.”.

Në katalogun teknik të paraqitur nga OE nuk ka asnjë artikull të markuar dhe shënuar me numër rendor që përcakton Solucionin Aditiv PAS.

- Pika që i referohet OE në ankesën e tij, vlen për qeset e gjakut dhe solucionet shtesë të gjakut që ato përmbajnë dhe jo për solucionin aditiv PAS.

- Solucioni aditiv PAS për ruajtjen e trombociteve është një produkt farmaceutik, që nuk vjen i ambalazhuar në qese gjaku. Ai është një produkt farmaceutik që shërben si zëvendësues i plazmës në prodhimin e ruajtjen e trombociteve dhe ka në përbërje të tij, ndër të tjera, elektrolite dhe sodium citrat, i cili i shtohet gjatë prodhimit të trombociteve nga buffy coats dhe siguron ruajtje më cilësore të tyre.

- Katalogu teknik për këtë solucion është i domosdoshëm për të përcaktuar nëse përbërja e tij është e përshtatshme për të garantuar ruajtjen e trombociteve deri në shtatë ditë, si dhe për të vlerësuar nëse sasia e solucionit të ofruar nga OE përkon atë të kërkuar, siç përcaktohen në Formularin e specifikimeve teknike të produktit.

- Sa më sipër, pretendimi i Operatorit Ekonomik ankimes nuk qëndron.

OE TRIMED është skualifikuar pasi - Nuk ka paraqitur certifikatë CE ose FDA (klas III) për sol.PAS

Argumentimi i OE referuar këtij pretendimi është, KVO ngre pretendimin se ky solucion klasifikohet si risk: klasi III. Direktiva 93/42/EEC ka parashikuar ndarjen klasifikimit e pajisjeve mjekësore. Për tu gjendur para klasit të fundit, direktiva shprehimisht në shtojcën IX, pika 4.1, ka parashikuar se: “Të gjitha pajisjet që përfshijnë, si pjesë përbërëse, një substancë e cila, nëse përdoret veçmas, mund të konsiderohet si një produkt mjekësor, siç përcaktohet në nenin 1 të Direktivës 65/65/EEC, dhe që mund të veprojnë në trupin e njeriut me veprim ndihmës me atë të pajisjeve, janë në klasën III.”;

Pika 4.2:

“Të gjitha pajisjet e përdorura për kontracepsionin ose parandalimin e transmetimit të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme janë në klasën IIb, përveç nëse janë pajisje të implantueshme ose invazive afatgjatë, në të cilin rast janë në klasën III.”;

Pika 4.5:

“Të gjitha pajisjet e prodhuara duke përdorur inde shtazore ose derivate të bëra jo të zbatueshme janë të klasit III, përveç rasteve kur pajisje të tilla synohen të vijnë në kontakt vetëm me lëkurën e paprekur.”. pra, siç konstatohet, ky solucion nuk kategorizohet në asnjë prej pikave të mësipërme.

Klasi III i pajisjeve mjekësore përfshin:

**Pajisje të implantueshme për përdorim të rastit me qëllim diagnostikimin, monitorimin dhe/ose korrigjimin e një defekti të zemrës ose të sistemit qendror të qarkullimit të gjakut përmes kontaktit të dpd me këto pjesë të trupit,*

**Pajisje të implantueshme për përdorim afat-shkurtër me qëllim diagnostikimin, monitorimin ose korrigjimin e një defekti të zemrës ose të sistemit qendror të qarkullimit të gjakut përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me këto pjesë të trupit, ose posaçërisht për përdorim në kontakt të drejtpërdrejtë me sistemin nervor qendror, ose të kenë një efekt biologjik/të përthithen tërësisht ose kryesisht nga trupi.*

**Pajisje të impantueshme për përdorim afat-gjatë me qëllim përdorimin përmes kontaktit të drejtpërdrejt me zemrën, sistemin qendror të qarkullimit ose sistemin qendror nervor, ose të kenë një efekt biologjik/të përthithen tërësisht ose kryesisht nga trupi.*

Në këtë pikëpamje, solucionin aditiv nuk qëndron si pajisje mjekësore e klasifikuar më vete, pasi si e tillë ajo nuk ka asnjë funksion dhe asnjë përdorim. Ky produkt është detyrimisht i shoqëruar me qesen e gjakut për të cilën përdoret dhe për pasojë kur një aksesor nuk ka asnjë funksion si pajisje mjekësore me vete, ajo ndjek fatin e pajisjes mjekësore kryesore, në këtë rast, solucionin ndjek fatin e qeses së gjakut në pikëpamjen juridike të certifikimit CE.

Sa më sipër arsyeja juaj për skualifikim nuk qëndron.

KSHA analizoi të gjitha dokumentet e paraqitura nga OE TRIMED ShPK dhe rezultoi se pretendimi për këtë pikë nuk qëndron.

- Në bazë të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit për këtë Lot pika 2.3, c: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose FDA ose deklaratë konformiteti CE ose FDA (Aty ku është e aplikueshme), për të gjithë artikujt e ofruar sipas kategorizimit të tyre (Dokumentat duhet të jenë të perkthyer dhe të noterizuar).” OE nuk ka paraqitur certifikatë CE ose FDA Class III për solucionin aditiv PAS.

- Argumentimi i OE se ky solucion nuk është Class III, nuk është i saktë pasi ky produkt farmaceutik përfshihet pikërisht në Shtojcën IX, pika 4.1 të Direktivës 93/42/EEC: “Të gjitha pajisjet që përfshijnë, si pjesë përbërëse, një substancë e cila, nëse përdoret veçmas, mund të konsiderohet si një produkt mjekësor, siç përcaktohet në nenin 1 të Direktivës 65/65/EEC, dhe që mund të veprojnë në trupin e njeriut me veprim ndihmës me atë të pajisjeve, janë në Klasën III”.

- Solucionin aditiv PAS për ruajtjen e trombociteve është një produkt farmaceutik që nuk vjen i ambalazhuar në qese gjaku plastik PVC, përkundrazi materiali ambalazhues nuk përmban PVC. Ai është një produkt farmaceutik që shërben si zëvendësues i plazmës në prodhimin e ruajtjen e trombociteve dhe ka në përbërje të tij, ndër të tjera, elektrolite dhe sodium citrat

(të cilat kur përdoren veçmas konsiderohen produkt medicinal), i cili i shtohet giatë prodhimit të trombociteve nga buffy coats dhe siguron ruajtje me cilësore të tyre. .

- Certifikimi Class II2b i paraqitur nga OE është i vlefshëm VETËM për qeset e gjakut: “Produktet mjekësore: Qese gjaku plastike”, shkëputur nga EC Certificate of Conformity në faqen 51 të Dokumente Origjinale Loti 1, sipas përkthimit zyrtar të paraqitur nga OE, në dokumentin Përkthime + Noterizime Loti 1, faqja 64.

Nëse OE do të ishte njohur paraprakisht me katalogun teknik të Solucionit PAS, apo do të dispononte së paku një mostër me etiketë me informacionin e duhur teknik për këtë produkt, do të ishte dakord me konkluzionet e KVO.

Sa më sipër, pretendimi i Operatorit Ekonomik ankimues nuk qëndron.

OE TRIMED është skualifikuar pasi - Nuk ka informacion nëse qeset e gjakut kanë kaluar procesin e pasterizimit.

Argumentimi i OE referuar këtij pretendimi është, në katalogun origjinal të ngarkuar në SPE, pra dokumenti i emëruar “DOKUME-1”, në faqen 24, jepet informacion i detajuar i etiketës së produktit sipas standardeve ISO 3826-1, ISO 15223-1 dhe ISBT 128. Megjithatë 3 faqe me informacion mbi piktogramet e etiketës, KVO duket se e ka neglizhuar, kjo pasi qartazi dallon shenja e sterilizimit me avull - thënë ndryshe, standartet mbi të cilat lëshohet ISO 3826-1, ISO 15223-1 dhe ISBT 128, e kanë kusht të detyrueshëm sterilizimin dhe pasterizimin e produktit. Pra nuk mund të certifikohet një produkt me ISO 3826-1, ISO 15223-1 dhe ISBT 128 pa kaluar në procesin e pasterizimit/sterilizimit. Në këtë pikëpamje, kjo përforcohet edhe nga shenjat konvencionale të përdorura në ambalazh ku ikona e mësipërme, tregon se produkti është i pasterizuar/sterilizuar.

Sa më sipër arsyeja juaj për skualifikim nuk qëndron.

KSHA i analizoi të gjitha dokumentat e paraqitura nga OE TRIMED ShPK dhe rezultoi se pretendimi për këtë pikë nuk qëndron.

- Në bazë të Formularit të Specifikimeve Teknike për Qese plastike për mbledhjen e gjakut, pika 5: “ Qeset duhet të jenë të sterilizuara dhe pasterizuara”, nuk ka dokumentacion apo të dhëna teknike që provojnë se qeset i janë nënshtruar procesit të pasterizimit.

Shpjegimi i ofruar nga OE në ankesën e tij nuk sqaron kërkesën për të cilin OE është skualifikuar, pasi standardet ISO të cilës OE i referohet si përmbush të kushtit të pasterizimit në të vërtetë nuk kanë lidhje me këtë proces. Sqarojmë më tej se:

- Standardi ISO 3826-1, i referohet “Plastics collapsible containers for human blood and blood components” pra Qeseve plastike të palosshme për gjakun dhe komponentëve të tij. Ky standard specifikon kërkesat për qeset plastike për mbledhjen dhe përpunimin e gjakut. Përmbushja e këtij standardi (e marrë e mirëqenë nga KVO vetëm nga përmbajtja e etiketës në katalogun teknik të paraqitur nga OE) plotëson kriteret 1-4 tëspecifikimeve teknike për qese plastike për mbledhjen e gjakut. Ai nuk ofron informacion mbi procesin e pasterizimit.

- Standardi ISO 15223-1, i referohet “Medical devices — Symbols to be used ëith information to be supplied by the manufacturer” pra Pajisjet mjekësore - Simbolet që do të përdoren me informacionin që do të jepet nga prodhuesi. Ky standard specifikon kërkesat për llojin e simboleve që do të përdoren nga prodhuesit në një qese gjaku, dhe synon unifikimin e simbolikës midis prodhuesve të ndryshëm të të njëjtit produkt, por nuk garanton se procesi i pasterizimit është i kryer. Pasterizimi i qeseve të gjakut nuk është ne kriteret përmbushës të këtij standardi.

- Standardi ISB 128 është standardi global për terminologjinë, identifikimin, kodimin dhe etiketimin e produkteve mjekësore me origjinë humane (përfshirë gjakun, qelizat, indet, qumështin dhe produktet e organeve). Ky standard synon unifikimin e terminologjisë dhe kodifikimit të produkteve me origjinë humane dhe nuk ka asnjë ndikim në procesin e pasterizimit apo sterilizimit të produkteve.

Kështu, pretendimi i OE, se përmbushja e tre standardeve të mësipërm, jep informacion dhe garanton pasterizimin e produkteve bie poshtë.

Sa më sipër, pretendimi i Operatorit Ekonomik ankimues nuk qëndron.

OE TRIMED është skualifikuar pasi - Nuk ka informacion nëse OE do të sigurojë 3 pajisje automatike për ndarjen e gjakut dhe adaptues për kupat e centrifugës.

Argumentimi i OE referuar këtij pretendimi është, kjo kërkesë e AK është përfshirë nën rubrikën e specifikimeve teknik dhe jo tek kriteret e përgjithshme apo të veçanta të kualifikimit. Gjithashtu për përmbushjen e këtij specifikimi nuk ka kërkuar një deklaratë të posaçme. Kështu, për rrjedhojë me qëllim përmbushjen e këtij specifikimi, është ngarkuar në sistem Shtojca 8, e cila në rubrikën e përmbushjes së specifikimeve teknik përmban: “Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga autoriteti/enti kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga autoriteti/enti kontraktor.”, kështu, ky kriter konsiderohet i plotësuar nga ana e OE.

KSHA analizoi të gjithë dokumentet e paraqitur nga OE TRIMED SHPK dhe rezultoi se pretendimi për këtë pikë nuk qëndron.

Në bazë të Formularit të Specifikimeve Teknike për Qese Plastike për mbledhjen e gjakut, Specifikime të Veçanta paragrafi i fundit: “Bashkë me sasinë e qesve duhet të sigurohen edhe tre pajisje automatike për ndarjen e gjakut të mbledhur me sistemin top & bottom, Si dhe 13 adaptues për kupat e centrifugës së përpunimit të gjakut, së bashku me disa kapëse plastike të thjeshta.”.

- OE nuk ka vënë në dispozicion asnjë informacion/dokumentacion (përfshirë Katalog Teknik) që të provojë faktin që e përmbush këtë kriter të rëndësishëm të specifikimeve teknike.

- Në bazë të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit paragrafi i fundit: “Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.”. Sa më sipër, pretendimi i Operatorit Ekonomik ankimues nuk qëndron.”.

II.8. Me shkresën nr. 1118/4 prot, datë 22.05.2024, “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “TRIMED” SHPK” Komisioni i Prokurimit Publik kërkoi nga ana e autoritetit kontraktor dokumentacionin e tij lidhur me hartimin e specifikimeve teknike, si dhe mostrat e dorëzuara nga ana e ofertuesi “TRIMED” SHPK për artikujt objekt-prokurimi, të përcaktuara në Shtojcën 6 “FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.9. Me shkresën nr. 66/51 prot, datë 20.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 1118/6 prot datë 24.05.2024, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i kërkuar me shkresën nr. 1118/4 prot, datë 22.05.2024, “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “TRIMED” SHPK”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatori ekonomik “TRIMED” SHPK mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi si në vijim: “OE TRIMED është skualifikuar pasi:- origjina e mallit dhe kompania prodhuese e deklaruar në Deklaratën e OE nuk është e njëjtë me atë të paraqitur në certifikatën e CE”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 2.3.b “Kapaciteti teknike” të pikës 2 “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, Loti 1, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriteret e veçanta kualifikues si më poshtë vijon:

“2.3 Kapaciteti teknik:

b. Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese

III.1.2. Në shtojcën 5 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE”, të dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor ka publikuar specifikimet teknike të artikujve objekt-prokurimi si më poshtë vijon:

“Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Lot.1 “Qese gjaku për mbledhjen dhe përpunimin e gjakut”

Lot.2 “Filtër Deleukocitar dhe bashkues laborator për masat trombocitar”

Lot.3 “Materiale të ndryshme konsumi mjekësore”

Lot.4 “Sete për REVEOS, Sistemin MIRASOL për inaktivizimin viral të produkteve të gjakut dhe Aksesorë ngjitës për TSCD II”

LOTI NR. 1

Qese Gjaku për mbledhjen dhe përpunimin e gjakut

<i>N</i> <i>r</i>	<i>EMERTIMI</i>	<i>NJESIA</i>	<i>SASIA</i>
----------------------	-----------------	---------------	--------------

1*	Qese gjaku katërshe top & bottom	Copë	17.000
2*	Qese gjaku treshe	Copë	14.000
3*	Qese gjaku katërshe	Copë	2.000
4*	Qese për prodhimin e trombocitit + sol	Copë	600

SPECIFIKIMET TEKNIKE
SPECIFIKIME TEKNIKE PER QESE PLASTIKE PER MBLEDHJEN E GJAKUT

Duke u mbështetur në rekomandimet e Këshillit të Europës për cilesinë e gjakut dhe komponentëve të tij, si edhe në Praktikën e Mira Transfuzionale (**GMP**) specifikimet teknike që duhet të plotësojnë qeset e gjakut duhet të jenë si më poshtë:

Të përgjithshme:

1. Qese plastike treshe, katërshe e thjeshtë, qese katërshe top&bottom, për mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e gjakut dhe komponentëve të tij.
2. Materiali plastik bazë PVC (Poly Vinyl Chloride), apirogen dhe jotoksik. Qesja për mbledhjen e gjakut me solucion antikoagulant CPD dhe qesja sekondare me solucion shtese për eritrocitet SAGM të këtyre plastikier të pershtatshëm për ruajtjen e eritrociteve. Po kështu edhe qeset satelite (bosh) të jenë të pershtatshme për ruajtjen perkatesisht të plazmes ose trombociteve. Në etiketen e qeses duhet të shenohet që qesja është e pershtatshme për ruajtjen e trombociteve deri në 5 dite. Lloji i materialit plastik duhet të referohet në oferte.
3. Volumi i qeses primare duhet të jetë i pershtatshëm për të mbledhur 450 ml gjak të plotë, ndërsa qeset satelite duhet të kenë një volum 300-400 ml. Sasia e solucionit antikoagulues CPD në qesen primare duhet të jetë 63 ml, ndërsa sasia e solucionit ruajtës të eritrociteve SAGM duhet të jetë 100 ml.
4. Qesja duhet të ketë transparencë të mjaftueshme që të lejojë ekzaminimin vizual të permbajtjes së saj përpara dhe pas mbledhjes së gjakut.

Pjesa e dhurimit duhet të përmbajë:

- a. Agen për dhuruesin, të madhësisë 16 G
- b. Mbulesën e ages
- c. Mbrojtësin e ages për t'u mbyllur në fund të dhurimit, që mundeson mbrojtjen e stafit nga shpimi (needle guard).
- d. Kanula break away duhet të jetë e pozicionuar në linjen e dhurimit mbi konektorin Y

Pjesa e mostrës duhet të përmbajë:

- a. Qesen e vogël për mbledhjen/marrjen e mostrës me një sistem vacutainer të integruar (sampling pouch e integruar me tubë vakuum).
- b. Tubi i dhurimit dhe tubi i qeses (xhep) të marrjes së mostrës duhet të jenë të dy të pajisur me kleme (clamp) me vete, në mënyrë që të mos lejohet kalimi në sistem i sasise fillestare të dhurimit, të terhequr në qesen (xhep). Kjo është mjaft e rëndësishme për të evituar një kontaminim të mundshëm bakterial të gjakut. Të gjithë tubat e sistemit të qeseve duhet të jenë të bute e lehtësisht të manipulueshem në mënyrë që të shmangen problemet gjatë saldimit të tyre me sealer.

Pjesa e mbledhjes dhe përpunimit duhet të përmbajë:

- a. *Një ose disa «outlet porte» ne qeset qe do te ruhen komponentet e gjakut. Keto duhet te jene me mbyllje jo te ringjiteshme, duhet te sigurojne nje lidhje te sigurt me sistemin e transfuzionit ku te mos kete rrjedhe ne vendin e inserimit e gjate perdorimit, duke perfshire ketu edhe zbrazjen nen presion.*
5. *Qeset duhet të jenë të sterilizuara dhe pasterizuara.*
6. ***Paketimi :*** *Të jene te paketuara ne sisteme te mbyllur hermetikisht me membrane dhe me nje mbulues te sigurve per te ruajtur sterilitetin e siperfaqes se brendshme te tij. Materiali paketues duhet te jete rezistent ndaj faktoreve te mjedisit sidomos ndaj lageshtires dhe te hapet lehtesisht pa kerkuar pajisje te vecanta per kete.*
7. ***Etiketimi:*** *Materiali i etiketes se qeses se gjakut duhet te kete perberje PVC. Boja e perdorur per pergatitjen e etiketes nuk duhet te difuzoje nepermjet materialit plastik ne brendesi te qeses. Shkrimi duhet te jete i qarte dhe të mbetet i lexueshem deri në daten e skadences.*
Etiketa e qeses se gjakut duhet te jete e qendrueshme gjate perpunimit dhe te permbaje edhe keto te dhena:
 - nr.lotit dhe serise se prodhimit;
 - emri sol antikoagulant, elementet perberes dhe sasite e tyre;
 - emri dhe adresa e prodhuesit;
 - temperaturen e ruajtjes.
8. *Skadencia te jete, **jo me pak se 12 muaj** dhe kjo te jete e shenuar ne etiketen e qeses ose në ambalazhin individual te saj.*

Të vecanta:

1. *Qeset për prodhimin e trombociteve nga **pool buffy-coat** duhet të jenë me volum të paktën 1000 ml. për mbledhjen e gjithë buffy-coat dhe të jenë të përshtatshme për lidhjen në zinxhir të tyre si dhe për lidhjen me solucionin ruajtës të trombociteve (PAS).*

Modeli i qeseve të ofruara nga firmat perkatese, me të gjitha elementet e kërkuara në këto specifikime, duhet t'i paraqitet paraprakisht Komisionit.

P S: Bashkë me sasinë e qeseve duhet të sigurohen edhe tre pajisje automatike për ndarjen e gjakut të mbledhur me sistemin top & bottom. Si dhe 13 adaptues per kupat e centrifuges se perpunimit te gjakut, së bashku me disa kapëse plastike të thjeshta.

SOLUCION ADITIV PER RUAJTJEN E TROMBOCITEVE (PAS)

Përbërja kimike e solucionit ruajtës për trombocitet duhet të jetë e përshtatshme që të garantojë ruajtjen e trombociteve deri në shtatë ditë.

***Volumi:** 300ml ± 20ml*

Afati i lëvrimit:

Sipas kërkesave të Autoritetit kontraktor

Duke filluar menjëherë pas lidhjes së Marrëveshjes Kuader me afat 12 (dymbëdhjetë) muaj.”.

III.1.3. Nga verifikimi në sistemin elektronik, në përmbushje të këtyre kritereve kualifikuese, operatori ekonomik “TRIMED” SHPK ka paraqitur në sistem dokumentacionin si më poshtë:

- Për kriterin 2.3.b ka dorëzuar në SPE dokumentin e mëposhtëm:

Deklaratë datë 05.04.2024, të bërë nga administratori i shoqërisë ku deklarohet si më poshtë vijon:

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia	Origjina e mallit	Kompania prodhuese
1	Qese gjaku katërshe top & bottom	Copë	17,000	xxxx	xxxx
2	Qese gjaku treshe	Copë	14,000	xxxx	xxxx
3	Qese gjaku katërshe	Copë	2,000	xxxx	xxxx
4	Qese për prodhimin e trombocitit + sol	Copë	600	xxxx	xxxx

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.5. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.6. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 8, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”.

III.1.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë, se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pika 2.3.b “Kapaciteti teknike” të pikës 2 “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, Loti 1, të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit ka kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik ofertues duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimues “TRIMED” ShPK, konstatohet, se ky i fundit ka paraqitur deklaratën e administratorit të shoqërisë sikurse është kërkuar në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.b “Kapaciteti teknike” të pikës 2 “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, Loti 1, të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit, duke deklaruar origjinën dhe kompaninë prodhuese të produktit të ofruar. Në këtë kuptim KPP gjykon, se operatori ekonomik “MEDFAU” ShPK plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.b “Kapaciteti teknike” të pikës 2 “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, Loti 1, të Shtojcës 7 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “TRIMED” ShPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatori ekonomik “TRIMED” SHPK mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi si në vijim: “OE TRIMED është skualifikuar pasi:- Mostra për sol.aditiv PAS nuk përmban asnjë informacion.”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 2.3.g “Kapaciteti teknike” të pikës 2 “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, Loti 1, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriteret e veçanta kualifikues si më poshtë vijon:

“2.3 Kapaciteti teknik:

g. Ofertuesit duhet të dorëzojnë mostra për të gjitha artikujt e shënuar me shënjën (*) në tabelën përkatëse për Lotin 1. Mostrat të dorëzohen pranë Komisionit të Vlersimit të Ofertave, në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjaku, të mbyllura në një zarf/kuti jo transparente të vulosur mbi të cilin të shënohet: Mos e hapni me perjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlersimit të Ofertve, të procedurës së prokurimit me objekt: **“Blerje qese për mbledhjen dhe përpunimin e gjakut, sete dhe filtra deleukocitare, materiale mjekësore të ndryshme konsumi, sete dhe aksesore”** e ndarë në lote - Marrveshje kuadër me disa operatorë ekonomike (një OE për secilin lot) ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara për një periudhë 12 mujore.

- Mostrat duhet të paraqiten në datën dhe orën e përcaktuar për hapje dhe vleresim ofertash. Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit..

III.2.2. Në shtojcën 5 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE”, të dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor ka publikuar specifikimet teknike të artikujve objekt-prokurimi si më poshtë vijon:

“Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Lot.1 “Qese gjaku për mbledhjen dhe përpunimin e gjakut”

Lot.2 “Filtra Deleukocitar dhe bashkues laborator për masat trombocitar”

Lot.3 “Materiale të ndryshme konsumi mjekësore”

Lot.4 “Sete për REVEOS, Sistemin MIRASOL për inaktivizimin viral të produkteve të gjakut dhe Aksesore ngjitës për TSCD II”

LOTI NR. 1

Qese Gjaku për mbledhjen dhe përpunimin e gjakut

N r	EMERTIMI	NJESIA	SASIA
1*	Qese gjaku katërshe top & bottom	Copë	17.000
2*	Qese gjaku treshe	Copë	14.000
3*	Qese gjaku katërshe	Copë	2.000
4*	Qese për prodhimin e trombocitit + sol	Copë	600

SPECIFIKIMET TEKNIKE

SPECIFIKIME TEKNIKE PER QESE PLASTIKE PER MBLEDHJEN E GJAKUT

Duke u mbështetur në rekomandimet e Këshillit të Europës për cilesinë e gjakut dhe komponentëve të tij, si edhe në Praktikën e Mira Transfuzionale (GMP) specifikimet teknike që duhet të plotësojnë qeset e gjakut duhet të jenë si më poshtë:

Të përgjithshme:

- g) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*
- h) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose*
- i) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.*

III.4.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për

operatorët ekonomikë, si dhe vepronjë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.4.8. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë, se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pika 2.3.c “Kapaciteti teknike” të pikës 2 “*KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT*”, Loti 1, të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit ka kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesin Certifikata konformiteti CE ose FDA ose deklarate konformiteti CE ose FDA (Aty ku është e aplikueshme), për të gjithë artikujt e ofruar sipas kategorizimit të tyre.

Nga verifikimi i dokumentacionit të ofertës të dorëzuara nga ana e operatorit ekonomik ankimues “TRIMED” ShPK, konstatohet, se ky i fundit ka paraqitur Certificate CE “EC Certificate” sipas Direktivës 93/42/EEC, nr. XXXX, e leshuar nga trupa XXXX, e cila vërteton se produktet: “Qese gjaku plastike” plotësojnë kërkesat e cilësisë sipas Direktivës 93/42/EEC, Shtojca II, sikurse është kërkuar në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.e “Kapaciteti teknike” të pikës 2 “*KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT*”, Loti 1, të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit, .

Në këtë kuptim KPP gjykon, se operatori ekonomik “TRIMED” ShPK plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.e “Kapaciteti teknike” të pikës 2 “*KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT*”, Loti 1, të Shtojcës 7 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “TRIMED” ShPK qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “TRIMED” SHPK mbi kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi si në vijim: “-Nuk ka informacion nëse qeset e gjakut kanë kaluar procesin e pasterizimit. ”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 7 “*Formulari i Krieteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit*” pika 2.3.g “Kapaciteti teknike” të pikës 2 “*KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT*”, Loti 1, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriteret e veçanta kualifikues si më poshtë vijon:

“2.3 Kapaciteti teknik:

e. Kërkohen të paraqiten katalogë teknike për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur sipas numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës. (Katalogët duhet të ngarkohen në eëë.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT (Dokumentat duhet të jene te perkthyer dhe te noterizuara).

III.5.2. Në shtojcën 5 “*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*”, të dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor ka publikuar specifikimet teknike të artikujve objekt-prokurimi si më poshtë vijon:

“Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]
FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Lot.1 “Qese gjaku për mbledhjen dhe përpunimin e gjakut”

Lot.2 “Filtra Deleukocitar dhe bashkues laboratorit për masat trombocitar”

Lot.3 “Materiale të ndryshme konsumi mjekësore”

Lot.4 “Sete për REVEOS, Sistemin MIRASOL për inaktivizimin viral të produkteve të gjakut dhe Aksesorë ngjitës për TSCD II”

LOTI NR. 1

Qese Gjaku për mbledhjen dhe përpunimin e gjakut

N r	EMERTIMI	NJESIA	SASIA
1*	Qese gjaku katërshe top & bottom	Copë	17.000
2*	Qese gjaku treshe	Copë	14.000
3*	Qese gjaku katërshe	Copë	2.000
4*	Qese për prodhimin e trombocitit + sol	Copë	600

SPECIFIKIMET TEKNIKE

SPECIFIKIME TEKNIKE PER QESE PLASTIKE PER MBLEDHJEN E GJAKUT

Duke u mbështetur në rekomandimet e Këshillit të Europës për cilësinë e gjakut dhe komponentëve të tij, si edhe në Praktikën e Mira Transfuzionale (GMP) specififikimet teknike që duhet të plotësojnë qeset e gjakut duhet të jenë si më poshtë:

Të përgjithshme:

4. Qese plastike treshe, katërshe e thjeshtë, qese katërshe top&bottom, për mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e gjakut dhe komponentëve të tij.
5. Materiali plastik bazë PVC (Poly Vinyl Chloride), apirogen dhe jotoksik. Qesja për mbledhjen e gjakut me solucion antikoagulant CPD dhe qesja sekondare me solucion shtese për eritrocitet SAGM të këtyre plastikier të pershtatshëm për ruajtjen e eritrociteve. Po kështu edhe qeset satelitare (bosh) të jenë të pershtatshme për ruajtjen perkatesisht të plazmes ose trombociteve. Në etiketën e qeses duhet të shënohet që qesja është e pershtatshme për ruajtjen e trombociteve deri në 5 ditë. Lloji i materialit plastik duhet të referohet në ofertë.
6. Volumi i qeses primare duhet të jetë i pershtatshëm për të mbledhur 450 ml gjak të plotë, ndërsa qeset satelitare duhet të kenë një volum 300-400 ml. Sasia e solucionit antikoagulues CPD në qesen primare duhet të jetë 63 ml, ndërsa sasia e solucionit ruajtës të eritrociteve SAGM duhet të jetë 100 ml.
4. Qesja duhet të ketë transparencë të mjaftueshme që të lejojë ekzaminimin vizual të përmbajtjes së saj përpara dhe pas mbledhjes së gjakut.

Pjesa e dhurimit duhet të përmbajë:

- a. Agen për dhuruesin, të madhësisë 16 G
- b. Mbulesën e ages
- c. Mbrojtësin e ages për t'u mbyllur në fund të dhurimit, që mundeson mbrojtjen e stafit nga shpimi (needle guard).
- d. Kanula break aëay duhet të jetë e pozicionuar në linjen e dhurimit mbi konektorin Y

Pjesa e mostrës duhet të përmbajë:

- a. Qesen e vogël për mbledhjen/marjen e mostrës me një sistem vacutainer të integruar (sampling pouch ëith integrated vacuum tube holder).
- b. Tubi i dhurimit dhe tubi i qeses (xhep) të marrjes së mostrave duhet të jenë të dy të pajisur me kleme (clamp) me vete, në mënyrë që të mos lejohet kalimi në sistem i sasise fillestare të dhurimit, të terhequr në qesen (xhep). Kjo është

mjaft e rendesishme per te evituar nje kontaminim te mundshem bakterial te gjakut. Të gjithë tubat e sistemit të qeseve duhet të jene të bute e lehtesisht të manipulueshem ne menyre që të shmangen problemet gjate saldimit të tyre me sealer.

Pjesa e mbledhjes dhe përpunimit duhet të përmbajë:

- a. Një ose disa «outlet porte» ne qeset qe do te ruhen komponentet e gjakut. Keto duhet te jene me mbyllje jo te ringjitetshme, duhet te sigurojne nje lidhje te sigurt me sistemin e transfuzionit ku te mos kete rrjedhe ne vendin e inserimit e gjate perdorimit, duke perfshire ketu edhe zbrazjen nen presion.

21. Qeset duhet të jenë të sterilizuara dhe pasterizuara.

22. ***Paketimi :*** Të jene te paketuara ne sisteme te mbyllur hermetikisht me membrane dhe me nje mbulues te sigurte per te ruajtur sterilitetin e siperfaqes se brendshme te tij. Materiali paketues duhet te jete rezistent ndaj faktoreve te mjedisit sidomos ndaj lageshtires dhe te hapet lehtesisht pa kerkuar pajisje te vecanta per kete.

23. ***Etiketimi:*** Materiali i etiketes se qeses se gjakut duhet te kete perberje PVC. Boja e perdorur per pergatitjen e etiketes nuk duhet te difuzoje nepermjet materialit plastik ne brendesi te qeses. Shkrimi duhet te jete i qarte dhe të mbetet i lexueshem deri në daten e skadences.

Etiketa e qeses se gjakut duhet te jete e qendrueshme gjate perpunimit dhe te permbaje edhe keto te dhena:

- nr.lotit dhe serise se prodhimit;
- emri sol antikoagulant, elementet perberes dhe sasite e tyre;
- emri dhe adresa e prodhuesit;
- temperaturen e ruajtjes.

24. Skadencia te jete, **jo me pak se 12 muaj** dhe kjo te jete e shenuar ne etiketen e qeses ose në ambalazhin individual te saj.

Të vecanta:

4. Qeset për prodhimin e trombociteve nga **pool buffy-coat** duhet të jenë me volum të paktën 1000 ml. për mbledhjen e gjithë buffy-coat dhe të jenë të përshtatshme për lidhjen në zinxhir të tyre si dhe për lidhjen me solucionin ruajtës të trombociteve (PAS).

Modeli i qeseve të ofruara nga firmat perkatese, me të gjitha elementet e kërkuara në këto specifikime, duhet t'i paraqitet paraprakisht Komisionit.

P S: Bashkë me sasinë e qeseve duhet të sigurohen edhe tre pajisje automatike për ndarjen e gjakut të mbledhur me sistemin top & bottom. Si dhe 13 adaptues per kupat e centrifuges se perpunimit te gjakut, së bashku me disa kapëse plastike të thjeshta.

SOLUCION ADITIV PER RUAJTJEN E TROMBOCITEVE (PAS)

Përbërja kimike e solucionit ruajtës për trombocitet duhet të jetë e përshtatshme që të garantojë ruajtjen e trombociteve deri në shtatë ditë.

Volumi: 300ml ± 20ml

Afati i lëvrim:

Sipas kërkesave të Autoritetit kontraktor

Duke filluar menjëherë pas lidhjes së Marrëveshjes Kuader me afat 12 (dymbëdhjetë) muaj.”.

III.5.3. Për plotësimin e këtij kriteri kualifikues operatori ekonomik ankiues “TRIMED” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Dokumentin e emërtuar “Dokumentat_origjinale_-_Loti_1_QKTGJ”, i cili përmban skeda teknike origjinale të artikujve objekt-prokurimi, në gjuhën angleze.
- Dokumentin e emërtuar “Trimed_ShPK_-Perkthime+_Noterizime_Loti_1”, i cili përmban skeda teknike të artikujve objekt-prokurimi, të përkthyer he noterizuar.
- Shtojcën 8 ‘Formulari Përmbledhës i vetëdeklarimit’, në seksionin “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimi, A: DEKLARATË” ka deklaruar si më poshtë vijon:

“Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [X] Jo []

III.5.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.5.5. Në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.5.6. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 6, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- j) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*
- k) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose*
- l) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.*

III.5.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i

barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepron në transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.5.8. Për sa i përket arsyes së skualifikimit se: ” *Nuk ka informacion nëse qeset e gjakut kanë kaluar procesin e pasterizimit.*”, KPP nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, konstaton, se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit, të përcaktuar në pika 2.3.c “Kapaciteti teknike” të pikës 2 “**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**”, Loti 1, të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit ka kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik ofertues duhet të katalog për të vërtetuar plotësimin e specifikimeve teknike për artikujt objekt prokurimi. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, në përmbushje të kriterit të mësipërm, konstatohet, se artikujt objekt-prokurimi të ofruar prej ankimuesit janë të sterilizuar.

Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa më sipër, referuar arsyes së skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, konstatohet, se në Shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” operatori ekonomik ankimues ka deklaruar se artikujt e ofertuar i plotësojnë specifikimet teknike, duke krijuar indicie mbi përmbushjen e këtij kriteri.

Me qëllim që këto indicie të shërbejnë si provë për përmbushjen e kriterit, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor para konstatimit të tij për skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues, duhet të kërkonte sqarime në lidhje me faktin nëse këto artikuj të ofruar janë të pasterizuar.

Referuar nenit 92 pika 1 të *lex specialis* në të cilin përcaktohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.” Autoritetit kontraktor për një shqyrtim të drejtë dhe objektiv të çështjes pa cenuar përmbajtjen e ofertës dhe duke mos pasur si qëllim ndikimin në vlefshmërinë e tyre, sa herë lind nevoja për sqarime mbi ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, ka detyrimin ligjor që në mbështetje të nenit 92 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, t’i drejtohet me kërkesë për sqarim operatorëve ekonomikë, në përmbushje të qëllimit të *lex specialis* të parashikuar në nenin 2 të tij.

Sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.6. Lidhur me pretendimet e operatori ekonomik “TRIMED” SHPK mbi kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi si në vijim: “-Nuk ka informacion nëse OE do të sigurojë 3 pajisje automatike për ndarjen e gjakut dhe adaptues për kupa të centrifugës”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 7 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 2.3.g “Kapaciteti teknike” të pikës 2 “KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT”, Loti 1, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriteret e veçanta kualifikues si më poshtë vijon:

“2.3 Kapaciteti teknik:

e. Kërkohen të paraqiten katalogë teknike për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur sipas numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës. (Katalogët duhet të ngarkohen në ëëë.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT (Dokumentat duhet të jenë të perkthyer dhe të noterizuara).

III.6.2. Në shtojcën 5 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE”, të dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor ka publikuar specifikimet teknike të artikujve objekt-prokurimi si më poshtë vijon:

“Shtojca 5.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Lot.1 “Qese gjaku për mbledhjen dhe përpunimin e gjakut”

Lot.2 “Filtër Deleukocitar dhe bashkues laborator për masat trombocitar”

Lot.3 “Materiale të ndryshme konsumi mjekësore”

Lot.4 “Sete për REVEOS, Sistemin MIRASOL për inaktivizimin viral të produkteve të gjakut dhe Aksesorë ngjitës për TSCD II”

LOTI NR. 1

Qese Gjakut për mbledhjen dhe përpunimin e gjakut

N r	EMERTIMI	NJESIA	SASIA
1*	Qese gjaku katërshe top & bottom	Copë	17.000
2*	Qese gjaku treshe	Copë	14.000
3*	Qese gjaku katërshe	Copë	2.000
4*	Qese për prodhimin e trombocitit + sol	Copë	600

SPECIFIKIMET TEKNIKE

SPECIFIKIME TEKNIKE PER QESE PLASTIKE PER MBLEDHJEN E GJAKUT

Duke u mbështetur në rekomandimet e Këshillit të Europës për cilesinë e gjakut dhe komponentëve të tij, si edhe në Praktikën e Mira Transfuzionale (GMP) specifikimet teknike që duhet të plotësojnë qeset e gjakut duhet të jenë si më poshtë:

Të përgjithshme:

1. Qese plastike treshe, katërshe e thjeshtë, qese katërshe top&bottom, për mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e gjakut dhe komponentëve të tij.

2. *Materiali plastik bazë PVC (Poly Vinyl Chloride), apirogen dhe jotoksik. Qesja për mbledhjen e gjakut me solucion antikoagulant CPD dhe qesja sekondare me solucion shtese për eritrocitet SAGM të kete plasticier të pershtatshem për ruajtjen e eritrociteve. Po kështu edhe qeset satelite (bosh) të jene të pershtatshme për ruajtjen perkatesisht të plazmes ose trombociteve. Në etiketen e qeses duhet të shenohet që qesja është e pershtatshme për ruajtjen e trombociteve deri në 5 dite. Lloji i materialit plastik duhet të referohet në oferte.*
3. *Volumi i qeses primare duhet të jete i pershtatshëm për të mbledhur 450 ml gjak të plotë, ndërsa qeset satelite duhet të kene një volum 300-400 ml. Sasia e solucionit antikoagulues CPD në qesen primare duhet të jete 63 ml, ndërsa sasia e solucionit ruajtes të eritrociteve SAGM duhet të jete 100 ml.*
4. *Qesja duhet të kete transparence të mjaftueshme që të lejoje ekzaminimin vizual të permbajtjes së saj përpara dhe pas mbledhjes së gjakut.*

Pjesa e dhurimit duhet të përmbajë:

- a. *Agjen për dhuruesin, të madhësisë 16 G*
- b. *Mbulesën e ages*
- c. *Mbrojtesin e ages për t'u mbyllur në fund të dhurimit, që mundeson mbrojtjen e stafit nga shpimi (needle guard).*
- d. *Kanula break away duhet të jete e pozicionuar në linjen e dhurimit mbi konektorin Y*

Pjesa e mostrës duhet të përmbajë:

- a. *Qesen e vogël për mbledhjen/marrjen e mostrës me një sistem vacutainer të integruar (sampling pouch eëth integrated vacuum tube holder).*
- b. *Tubi i dhurimit dhe tubi i qeses (xhep) të marrjes së mostrave duhet të jene të dy të pajisur me kleme (clamp) me vete, në mënyrë që të mos lejohet kalimi në sistem i sasise fillestare të dhurimit, të terhequr në qesen (xhep). Kjo është mjaft e rëndësishme për të evituar një kontaminim të mundshëm bakterial të gjakut. Të gjithë tubat e sistemit të qeseve duhet të jene të bute e lehtësisht të manipulueshem në mënyrë që të shmangen problemet gjatë saldimit të tyre me sealer.*

Pjesa e mbledhjes dhe përpunimit duhet të përmbajë:

- a. *Një ose disa «outlet porte» në qeset që do të ruhen komponentet e gjakut. Keto duhet të jene me mbyllje jo të ringjithëshme, duhet të sigurojnë një lidhje të sigurt me sistemin e transfuzionit ku të mos kete rrjedhe në vendin e inserimit e gjatë përdorimit, duke përfshirë këtu edhe zbrazjen nën presion.*

25. Qeset duhet të jenë të sterilizuara dhe pasterizuara.

26. ***Paketimi :*** *Të jene të paketuara në sisteme të mbyllur hermetikisht me membrane dhe me një mbulues të sigurt për të ruajtur sterilitetin e sipërfaqes së brendshme të tij. Materiali paketues duhet të jete rezistent ndaj faktoreve të mjedisit sidomos ndaj lageshtires dhe të hapet lehtësisht pa kërkuar pajisje të vecanta për kete.*

27. ***Etiketimi:*** *Materiali i etiketes së qeses së gjakut duhet të kete përberje PVC. Boja e përdorur për përgatitjen e etiketes nuk duhet të difuzojë nepermjet materialit plastik në brendësi të qeses. Shkrimi duhet të jete i qartë dhe të mbetet i lexueshem deri në datën e skadences.*

Etiketa e qeses së gjakut duhet të jete e qendrueshme gjatë përpunimit dhe të përmbajë edhe keto të dhëna:

- nr.lotit dhe serise se prodhimit;
- emri sol antikoagulant, elementet perberes dhe sasite e tyre;
- emri dhe adresa e prodhuesit;
- temperaturen e ruajtjes.

28. Skadenca te jete, **jo me pak se 12 muaj** dhe kjo te jete e shenuar ne etiketen e qeses ose në ambalazhin individual te saj.

Të vecanta:

1. Qeset për prodhimin e trombociteve nga **pool buffy-coat** duhet të jenë me volum të paktën 1000 ml. për mbledhjen e gjithë buffy-coat dhe të jenë të përshtatshme për lidhjen në zinxhir të tyre si dhe për lidhjen me solucionin ruajtës të trombociteve (PAS).

Modeli i qeseve të ofruara nga firmat perkatese, me të gjitha elementet e kërkuara në këto specifikime, duhet t'i paraqitet paraprakisht Komisionit.

P S: Bashkë me sasinë e qeseve duhet të sigurohen edhe tre pajisje automatike për ndarjen e gjakut të mbledhur me sistemin top & bottom. Si dhe 13 adaptues per kupat e centrifuges se perpunimit te gjakut, së bashku me disa kapëse plastike të thjeshta.

SOLUCION ADITIV PER RUAJTJEN E TROMBOCITEVE (PAS)

Përbërja kimike e solucionit ruajtës për trombocitet duhet të jetë e përshtatshme që të garantojë ruajtjen e trombociteve deri në shtatë ditë.

Volumi: 300ml ± 20ml

Afati i lëvrimit:

Sipas kërkesave të Autoritetit kontraktor

Duke filluar menjëherë pas lidhjes së Marrëveshjes Kuader me afat 12 (dymbëdhjetë) muaj.”.

III.6.3. Për plotësimin e këtij kriteri kualifikues operatori ekonomik ankiues “TRIMED” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Dokumentin e emërtuar “Dokumentat _origjinale _ Loti 1_QKTGJ”, i cili përmban skeda teknike origjinale të artikujve objekt-prokurimi, në gjuhën angleze.
- Dokumentin e emërtuar “Trimed_ShPK_-Perkthime+_Noterizime_Loti_1”, i cili përmban skeda teknike të artikujve objekt-prokurimi, të përkthyer he noterizuar.
- Shtojcën 8 ‘Formulari Përmbledhës i vetëdeklarimit’, në seksionin “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimi, A: DEKLARATË” ka deklaruar si më poshtë vijon:

“Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim	Po [X] Jo []

<i>përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.</i>	
--	--

III.6.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.6.5. Në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.*
- 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të*

një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.6.6. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 6, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- m) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në*

kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

n) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

o) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.

III.6.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepron në transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.6.8. Për sa i përket arsyes së skualifikimit se: ” *Nuk ka informacion nëse OE do të sigurojë 3 pajisje automatike për ndarjen e gjakut dhe adaptues për kupat e centrifugës*”, KPP nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, konstaton, se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit, të përcaktuar në pika 2.3.c “Kapaciteti teknike” të pikës 2 “**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**”, Loti 1, të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit ka kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik ofertues duhet të katalog për të vërtetuar plotësimin e specifikimeve teknike për artikujt objekt prokurimi dhe në përmbushje të këtij kriteri kualifikues operatori ekonomik ankimes ka dorezuar skedat teknike për secilin prej artikujve objekt-prokurimi të ofruar prej tij në këtë procedurë prokurimi.

Nga shqyrtimi i Shtojcës 5 “**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**” autoriteti kontraktor ndër të tjera ka përcaktuar si në vijim: “*P.S: Bashkë me sasinë e qeseve duhet të sigurohen edhe tre pajisje automatike për ndarjen e gjakut të mbledhur me sistemin top &*

bottom. Si dhe 13 adaptues per kupat e centrifuges se perpunimit te gjakut, se bashku me disa kapese plastike te thjeshta.”, Komisioni konstaton se enti prokurues ka kërkuar që operatori ekonomik që do të shpallet fitues i procedurës duhet që sëbashku me produktet e ofruara të sjellë edhe tre pajisje automatike për ndarjen e gjakut dhe 13 (trembëdhjetë) adaptues për kupat e centrifugës së përpunimit të gjakut.

Gjithashtu nga shqyrtimi i Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit, Komisioni konstaton se nga ana e autoritetit kontraktor nuk është përcaktuar asnjë kriter kualifikues ku nga ana e operatorëve ekonomik ofertues të deklarohet që do të sigurojë për entin prokurues tre pajisje automatike për ndarjen e gjakut dhe 13 (trembëdhjetë) adaptues për kupat e centrifugës së përpunimit të gjakut.

Nga shqyrtimi i arsyes së skualifikimit, dokumentave të tenderit dhe dokumentacionit të ofrës së dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimues, Komisioni gjykon se arsyeja e mësipërme e skualifikimit është mbështetur mbi një kriter të pakërkuar, si dhe për më tepër operatori ekonomik ankimues në dokumentacionin e ofertës ka dorëzuar Shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” ku ky i fundit ka deklaruar se merr përsipër të realizojë objektin e prokurimit në përputhje me specifikimet teknike.

Në këtë kuptim KPP gjykon, se arsyeja e mësipërme e skualifikimit nuk qëndron, pasi është mbështetur mbi një kriter të pakërkuar dhe të pa përcaktuar në Shtojcën 7 të dokumentave të tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “TRIMED” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, te Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “TRIMED” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-97276-03-04-2024, me objekt: “Blerje qese për mbledhjen dhe përpunimin e gjakut, sete dhe filtra deleukocitare, materiale mjekësore të ndryshme konsumi, sete dhe aksesore” e ndarë në lote”, me fond limit: 114,486,970 (njëqind e katërmëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) Lekë pa TVSH ose fondi limit ne Euro (sipas kursit të këmbimit nga BSH): 1,101,365.75 (Një milion e njëqind e një mijë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë shtatëdhjetë e pesë) Euro pa Tvsh, Loti 1 me numër reference: REF-97281-03-04-2024, me objekt: “Qese

gjaku për mbledhjen dhe përpunimin e gjakut”, me fond limit të lotit 26,260,000 (njëzet e gjashtë milion e dyqind e gjashtëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH ose fondi limit ne Euro (sipas kursit të këmbimit nga BSH): 252,621.45 (Dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e njëzet e një pikë dyzet e pesë) Euro pa TVSH zhvilluar në datën 05.04.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut.

2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “TRIMED” SHPK, të korrigjojë shkeljet e konstatuara, si dhe të kryejë veprimet procedurale në lidhje me zbatimin e konstatimeve të më sipërme.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “TRIMED” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
KreshnikTernova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

